

Emancipimi Civil Ma Ndryshe

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur

31 DHJETOR 2015

Përmbajtja

| | |
|---|---|
| Raporti i Auditorit të Pavarur | 3 |
| Pasqyra e të Ardhurave dhe Fondeve të Shfrytëzuara..... | 4 |
| Bilanci i Gjendjes..... | 5 |
| Shënimet e Pasqyrave Financiare | 6 |

Raporti i Auditorit të Pavarur

Për Menaxhmentin e OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe, Prishtinë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (më tej si OJQ "EC Ma Ndryshe") që përbëhet nga Pasqyrën e të Ardhurave dhe fondeve të shfrytëzuara për periudhën 1 Janar 2015 deri më 31 Dhjetor 2015, Bilanci i Gjendjes në datën 31 Dhjetor 2015, , si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Përgjegjësia e menaxhmentit për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përpilimin dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me Standardet Kosovare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontroleve të brendshme relevante për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të cilat janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të gabimeve dhe mashtrimeve, përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të përshtatshme kontabël, si dhe realizimin e vlerësimeve kontabël që janë të arsyeshme në rrethana të caktuara.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne kemi bërë auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë përputhshmëri me kërkesat etike si dhe planifikimin dhe kryerjen e auditimit për të arritur siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar prova për shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë si rezultat i mashtrimit ose gabimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të riskut, auditori merr parasysh kontrollat e brendshme relevante për përgatitjen dhe prezantimin korrekt të pasqyrave financiare nga ana e entitetit në mënyrë që të dizajnohen procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit në efikasitetin e kontroleve të brendshme të entitetit. Auditimi po ashtu përfshinë vlerësimin e përshtatjes së politikave të përdorura kontabël si dhe arsyeshmerinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që neve i kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të duhura të ofrojnë bazë për opinionin tonë.


Opinion i pakualifikuar

Sipas mendimit tonë, *pasqyrat financiare të bashkangjitura (sipas parimit të Kesh-it) japin një pamje të vërtete dhe të drejtë, në aspektin material pozitiv financiar të OJQ "Emancipimi Civil Ma Ndryshe" me 31 Dhjetorit 2015 në përputhje me politikat kontabël dhe procedurat e shpalosura në Shenimin 2.*

ETIKA

Prishtinë, Kosovë

Prill 2016




Emancipimi Civil Ma Ndryshe

Pasqyra e të Ardhurave dhe Fondeve të Shfrytëzuara, për periudhën
01.01.2015 – 31.12.2015

| | | 2015 | 2014 |
|---|---|--------------|--------------|
| Fondet | | | |
| Grantet (donacionet) | 3 | € 262,902.30 | € 244,357.86 |
| Te Hyrat tjera | | | |
| Total te hyrat | | € 262,902.30 | € 244,357.86 |
| Shpenzimet | | | |
| Pagat dhe Kontributet | 4 | € 94,880.96 | € 103,645.43 |
| Qeraja | | € 8,100.00 | € 6,600.00 |
| Shpenzimet e Projekteve | | € 129,146.01 | € 102,436.32 |
| Grantet e dhena | | | € 1,810.00 |
| Shpenzimet Administrative | | € 15,455.86 | |
| Provizionet bankare | | € 295.61 | € 353.34 |
| Auditimi | | € 1,370.00 | € 605.00 |
| Tjera | | € - | € - |
| Total Shpenzimet | | € 249,248.44 | € 215,450.09 |
| Mbetja e fondeve mbi shpenzimet | | € 13,653.86 | € 28,907.77 |
| Paraja kesh dhe ne bank ne fillim te periudhes | 5 | € 34,786.05 | € 5,878.28 |
| Paraja kesh dhe ne bank ne fund te periudhes | 5 | € 48,439.91 | € 34,786.05 |

Të autorizuar nga menaxhmenti:
Hajrulla Çeku

Drejtor Ekzekutiv



Admir Istrefi

Menaxher i financave

Bilanci i Gjendjes, më 31.12.2015

| Asetet Rrjedhese: | Notes | 2015 | 2014 |
|---------------------------------------|-------|--------------------|--------------------|
| Asetet Rrjedhese: | | | |
| Paraja në Arkë dhe në Bankë | 5 | € 48,439.91 | € 34,787.21 |
| Llogaritë e Arkëtueshme | | | |
| Kerkesat Tjera | | € 4,760.20 | € 8,983.92 |
| Total Asetet Rrjedhese: | | € 53,200.11 | € 43,771.13 |
| Total asetet | | € 53,200.11 | € 43,771.13 |
| Detyrimet dhe fondet e bartura | | | |
| Detyrimet Afatshkurtra: | | | |
| Pagat e Pagushme | | | |
| Llogarite e Pagushme | | | |
| Tjera | | | |
| Total detyrimet afatshkurta | | € | € |
| Fondet e mbetura | 6 | € 53,200.11 | € 43,771.13 |
| Total Fondet e bartura | | € 53,200.11 | € 43,771.13 |
| Total Detyrimet, dhe fondet | | € 53,200.11 | € 43,771.13 |

Të autorizuar nga menaxhmenti:

Hajrulla Çeku

Drejtor Ekzekutiv



Admir Istrefi

Menaxher i financave

Shënime të pasqyrave financiare

Të përgjithshme

Organizata jo-qeveritare “Emancipimi Civil Ma Ndryshe” u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Europës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave të Kulturës në Prizren dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor.

EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale në Prizrenit për të krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkëvendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike. Për të ofruar një model konkret të konsultimit publik, EC Ma Ndryshe ka realizuar projektin “Forumet e Hapura Qytetare”, ku instrumenti i forumit është promovuar si model funksional i pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje. Për më tepër, përmes Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, EC Ma Ndryshe ka ngritur një platformë avokuese për komunitetin kulturor të qytetit duke e shndërruar Forumin në një pjesëmarrës aktiv të formulimit të politikave kulturore në nivel lokal.

Në emër të promovimit të mekanizmave të demokracisë së drejtpërdrejtë, EC Ma Ndryshe ka qenë pjesë e dy Peticioneve në qytetin e Prizrenit, njëri për të parandaluar rrënimin e objektit të kinemasë së qytetit dhe tjetri për të kundërshtuar projekt-ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit. Njëra ndër veprimet konkrete me të rinjtë e qytetit ka qenë bashkëpunimi me Festivalin Dokufest për të shfaqur filma dokumentarë nxënësve të shkollave të mesme të qytetit. Temat e dokumentarëve kanë përfshirë një spektër të gjerë të edukimit qytetar me qëllim përgatitjen e gjeneratave të ardhshme që do të jenë qytetarisht të përgjegjshme dhe aktive. Aktivizmi është edhe një ndër parimet udhëheqëse të veprimit të brendshëm të organizatës. Përmes Grupit të Vullnetarëve Aktiv (grup që funksionon brenda EC Ma Ndryshe) organizata ka promovuar aktivitetin vullnetar në shumë fusha, e posaçërisht në kulturë dhe trashëgimi kulturore.

Programet dhe Projektet e EC Ma Ndryshe

- Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë (2014)
- Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren (2014)
- Transparenca online e komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2014)
- Rritja e pjesëmarrjes përmes mediave sociale në Prizren dhe Gjiçan (2013-2014)
- Qyteti gjithpërfshirës-Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2014)
- Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2014)
- Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore e zhvillimit të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2014)
- Zhvillimi rajonal përmes turizmit kulturor në Prizren (2014-2015)
- Prezentimi Kulturor i Prizrenit në Sllovaki (2014)

1. Politikat Kontabël

Pasqyrat financiare të bashkangjitura janë përgatitur për qëllime të plotësimit të detyrimeve që rrjedhin nga kontrata dhe paraqesin një pamje të plotë të ngjarjeve ekonomike si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve që paraqesin fondet e marra dhe të shfrytëzuara.

2.1 Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas kontabilitetit aktual të orjentuar prej SKK-ve të modifikuar me kontabilitetin mbi bazë Cash-i për njohjen e asetëve afatgjatë materiale, amortizimeve të lidhura me ato të cilat lidhen me aktivitetin jo fitimprurës të "EC Ma Ndryshe" të cilat janë njohur si shpenzime në momentin kur ato janë blerë lidhur me projekte të caktuara.

Pasqyrat janë përgatitur duke respektuar tërësinë materiale, në harmoni me kushtet dhe kriteret e menaxhimit të granteve të dhuruara nga ana e donatorëve si dhe në kuptim me udhëzimet dhe këshillimet e termave kontraktuese me secilin donator veç e veç.

Organizata harton përmbledhjen e shpenzimeve sipas linjave të buxhetit të projektit të miratuar për secilin projekt veç e veç duke përgaditur një pasqyrë të shpenzimeve të kryera (Raport Financiar) në zbatim të periudhave të raportimit të nënshkruar në kontratën e granteve.

Në përgjithësi këto rregulla dhe procedura duke pasur parasysh specifikimin e paragrafit të parë të këtij shënimi janë të orientuara nga Standardet Kombëtare dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK-ës).

2.2 Valuta Raportuese

Transaksionet e ndodhura tek OJQ "EC Ma Ndryshe" për këtë periudhë janë mbajtur në EURO ("EUR").

Emancipimi Civil Ma Ndryshe

3. Te hyrat e periudhës – Grantet (Donacionet)

| Kodi i projektit | Donatori | Projekti / Donatori | Të hyrat gjatë vitit 2015 | Të hyrat gjatë vitit 2014 |
|------------------|---|---|---------------------------|---------------------------|
| ATRC | USAID | Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë | 1,219.51 | 11,061.99 |
| ATRC P | USAID | ATRC Petition | | 1,000.00 |
| COE | Këshilli i Evropës, zyra në Prishtinë | Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore e zhvillimit të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2014) | 4,033.05 | 24,074.00 |
| SDC/KCSF | SDC/Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur | Zhvillimi strategjik i EC Ma Ndryshe | 31,500.00 | |
| KFOS | Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur | Analiza e trashëgimise kulturore | | 4,000.00 |
| KFOS | Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur | Urbanisem Watch | | 8,950.00 |
| KFOS | Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur | Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm | 8,200.00 | 8,200.00 |
| KFOS | Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur | Bashkëpunimi Kulturor Kosovë-Bosnje | 9,000.00 | |
| KFOS | Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur | EC për qytete transparente dhe gjithëpërfshirëse | 20,600.00 | |
| KFOS | Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur | Peticion për liberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës | 1,420.00 | |
| KFOS | Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur | Shkolla për Planifikim dhe Zhvillim Urban | 29,250.00 | |
| Online | Ambasada Britanike në Prishtinë | Indeksi i Transparences Komunale (2013-2014) | | 30,638.27 |
| Online | Ambasada Britanike në Prishtinë | Indeksi i Transparences Komunale (2014-2015) | 30,928.23 | 57,166.49 |
| Online | Ambasada Britanike në Prishtinë | Indeksi i Transparences Komunale (2015-2016) | 52,857.20 | |
| OPIC | Olof Palme International Center | Qyteti gjithëpërfshirës – planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren | 36,526.65 | 32,920.00 |
| OPIC NL | Olof Palme International Center | E-letter "Focus Kosovo" | 1,532.66 | 1,629.41 |
| CE | Këshilli i Evropës, zyra në Prishtinë | Trashëgimia kulturore ,shtyllë qendrore e zhvillimit të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren | | 3,438.91 |
| CE | Këshilli i Evropës, zyra në Prishtinë | Mbështetje për Promovimin e Diversitetit Kulturor (PDKK) (2015) | 535.00 | |
| UNDP GJ | UNDP | Mediat Sociale | | 4,944.00 |
| UNDP PZ | UNDP | Mediat Sociale | | 4,936.00 |
| UNDP | UNDP | Zhvillimi rajonal përmes turizmit kulturor në Prizren | 35,300.00 | 35,300.00 |
| US Embassy | US Embassy | Aktivizmi kulturor | | 16,098.23 |
| Total | | | 262,902.30 | 244,357.30 |

4. Shpenzimet sipas projekteve

| Kodi i projektit | Donatori | Projekti | Pagat dhe Kontributet | Qeraja | Shpenzimet e Projekteve | Grantet e dhena | Shpenzimet Administrative | Provizionet bankare | Auditimi | Total Shpenzimet |
|------------------|---|--|-----------------------|----------|-------------------------|-----------------|---------------------------|---------------------|----------|------------------|
| SDC/KCSF | SDC/Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur | Zhvillimi strategjik i EC Ma Ndryshe | 6,996.00 | 600.00 | 2,171.60 | | 520.00 | 5.25 | | 10,292.85 |
| KFOS | Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur | Urbanizimi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm | 12,000.00 | 400.00 | 2,900.00 | | 1,082.96 | 15.75 | | 16,398.71 |
| KFOS | Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur | Bashkëpunimi Kulturor Kosovë-Bosnje | | | | | | | | 0.00 |
| KFOS | Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur | EC për qytete transparente dhe gjithëpërfshirëse | 5,600.00 | 200.00 | 1,700.00 | | 645.05 | 4.50 | | 8,149.55 |
| KFOS | Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur | Peticion për liberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës | | | 1,420.00 | | | | | 1,420.00 |
| KFOS | Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur | Shkolla për Planifikim dhe Zhvillim Urban | 5,750.00 | | 18,735.00 | | 2,673.35 | 54.50 | | 27,212.85 |
| Online | Ambasada Britanike në Prishtinë | Indeksi i Transparences Komunale (2014-2015) | 16,238.00 | 1,200.00 | 6,982.19 | | 212.57 | 37.10 | 685.00 | 25,354.86 |
| Online | Ambasada Britanike në Prishtinë | Indeksi i Transparences Komunale (2015-2016) | 27,641.00 | 2,400.00 | 12,673.00 | | 3,968.53 | 27.00 | | 46,709.53 |

Emancipimi Civil Ma Ndryshe

| | | | | | | | | | | |
|------------|---------------------------------------|---|-----------|----------|------------|------|-----------|--------|----------|------------|
| OPIC | Olof Palme International Center | Qyteti gjithëpërshires – planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren | 12,672.00 | 2,400.00 | 20,355.67 | | 1,000.09 | 124.26 | | 36,552.02 |
| OPIC NL | Olof Palme International Center | E-letter "Focus Kosovo" | | | 1,524.41 | | | 8.25 | | 1,532.66 |
| CE | Këshilli i Evropës, zyra në Prishtinë | Mbështetje për Promovimin e Diversitetit Kulturor (PDKK) (2015) | | | 535.00 | | | | | 535.00 |
| UNDP | UNDP | Zhvillimi rajonal përmes turizmit kulturor në Prizren | 7,400.00 | 900.00 | 53,768.78 | | 693.43 | 13.50 | | 62,775.71 |
| US Embassy | US Embassy | Aktivizmi kulturor | 583.96 | | 6,380.36 | | 577.30 | 5.50 | | 7,547.12 |
| Tjera | Ec Ma Ndryshe | Shpenzime tjera te perbashketa | | | | | 4,082.58 | | 685.00 | 4,767.58 |
| Total | | | 94,880.96 | 8,100.00 | 129,146.01 | 0.00 | 15,455.86 | 295.61 | 1,370.00 | 249,248.44 |

5. Paraja e gatshme

| Pershkrimi | 2015 (ne EUR) | 2014 (ne EUR) |
|--|------------------|------------------|
| Paraja kesh dhe ne bank ne fillim te periudhes | 34,787.21 | 5,878.28 |
| Paraja kesh dhe ne bank ne fund te periudhes | 48,439.41 | 34,787.21 |

6. Fondet e mbetura

| Kodi i projektit | Donatori | Projekti | Bartja në fillim vitit 2015 | Të hyra gjatë vitit | Shpenzime të projekteve | Mbetja e fondeve në fund vitit 2015 |
|------------------|---|---|-----------------------------|---------------------|-------------------------|-------------------------------------|
| SDC/KCSF | SDC/Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur | Zhvillimi strategjik i EC Ma Ndryshe | | 31,500.00 | 10,292.85 | 21,207.15 |
| KFOS | Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur | Bashkëpunimi Kulturor Kosovë-Bosnje | | 9,000.00 | | 9,000.00 |
| KFOS | Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur | EC për qytete transparente dhe gjithëpërfshirëse | | 20,600.00 | 8,149.55 | 12,450.45 |
| KFOS | Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur | Shkolla për Planifikim dhe Zhvillim Urban | | 29,250.00 | 27,212.85 | 2,037.15 |
| Online | Ambasada Britanike në Prishtinë | Indeksi i Transparences Komunale (2014-2015) | (3,673.51) | 30,928.23 | 25,354.93 | 1,899.79 |
| Online | Ambasada Britanike në Prishtinë | Indeksi i Transparences Komunale (2015-2016) | | 52,857.20 | 46,709.43 | 6,147.77 |
| OPIC NL | Olof Palme International Center | E-letter "Focus Kosovo" | 403.21 | 1,532.66 | 1,532.66 | 403.21 |
| UNDP | UNDP | Zhvillimi rajonal përmes turizmit kulturor në Prizren | 27,529.00 | 35,300.00 | 62,774.41 | 54.59 |
| Total | | | 24,258.70 | 210,968.09 | 182,026.68 | 53,200.11 |

Të autorizuar nga menaxhmenti:

Hajrulla Çeku

Drejtor Ekzekutiv

Admir Istrefi

Menaxher i financave

